



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.19, datë 16.01.2023

PËR

“PEZULLIMIN E PROCEDIMIT DISIPLINOR TË FILLUAR NDAJ  
MAGJISTRATIT ME DETYRË, PROKUROR NË  
PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

Bazuar në nenet 149, pika 1 dhe 149/a, pika 1, germa “b” të Kushtetutës, nenin 145 në lidhje me nenin 126 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 184, germa “e” dhe 189, pika 1, germa “a” dhe pika 3, të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 66, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Komisionit Disiplinor, si dhe pasi dëgjoi edhe përfaqësuesit e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, zotin Besnik Maho dhe zotin Julian Zonja, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Pezullimin e procedimit disiplinor Nr.459/26, datë 23.11.2022, të filluar me kërkesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndaj magjistratit prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë sipas Relacionit bashkëlidhur.
2. Ky pezullim ka efekt deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit me vendim përfundimtar.
3. Ky vendim i njoftohet brenda afatit 5 ditor magjistratit dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare ëeb të Këshillit.
5. U shpall në Tiranë, sot më 16.01.2023.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR  
Alfred Balla

ANËTAR  
Sokol Stojani

ANËTAR  
Eloida Goxhi

ANËTAR  
Mirëla Bogdani

ANËTAR  
Bujar Sheshi

ANËTAR  
Esmeralda Keshi

ANËTAR  
Arta Mandro

ZV/KRYETAR  
Tartar Bazaj

ANËTAR  
Nurihan Seiti

ANËTAR  
Zeqir Hoda

ANËTAR  
Ledina Riza